



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.1705/2026
Data: 18.02.2026

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dytë -II- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 29.01.2026 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetarë i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsime), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Vjosa Rogaçi** (Zyrtare në Drejtorin e Arsimit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2026.
3. Raporti financiar për vitin 2025.
4. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2026.
5. Propozim vendim në parim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme .
6. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.
7. Propozim vendim për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.
8. Propozim vendim për përbërjen e komisionit komunal të aksionarëve të NPL Pastrimi.
9. Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026.
10. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2025.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri,

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson: Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës me numër 03/L040, neni 58 paragrafi h) dhe neni 40 paragrafi d), dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, neni 15 paragrafi c), Kryetari i Komunës harton planin e punës për vitin 2026. Fillimisht e kemi bërë grupin punues për hartimin e planit të punës për vitin 2026, që përfshinë zyret dhe drejtoritë, të cilët kanë punuar për hartimin e këtij plani. Grupi punues përbëhet prej: Kryetari i Komunës - Mehmet Ballazhi, Nënkryetari i komunës - Sevdi Dernjani, Zyra ligjore - Bajrush Laçi, Zyra e prokurimit - Xhevdet Bushi, Zyra e personelit - Betime Dernjani, Zyra e informimit - Bashkim Sopa, Zyrtari për të drejtat e njeriut, kundër diskriminimit dhe të drejtat e fëmijëve - Vjosa Livoreka Rogaçi, Drejtoreshë e drejtorisë për Administratë të Përgjithshme - Natyra Kalisi, Drejtoreshë e drejtorisë për Buxhet dhe Financa - Lindita Ballazhi, Drejtor i drejtorisë për Arsim - Hisni Luri, Drejtor i drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - Nexhmedin Daci, Drejtoreshë e drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Kimete Kuka Hasallari, Drejtor i drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë - Senad Kalisi, Drejtoreshë e drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Majlinda Kaloshi, Drejtor i drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Abdurraman Bushi, Drejtoreshë e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport - Arbenita Bajramaliu. Fokusi imë në këtë rast kanë qenë prioritetet për zhvillimin e komunës së Hanit të Elezit, të planifikuara për vitin 2026. Si prioritete janë: Shërbim cilësor dhe transparent ndaj qytetarëve, Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe rritja e mirëqenies sociale, Rregullimi i infrastrukturës dhe zhvillimi urbanistik i qëndrueshëm, Arsimi, familja dhe rritja e sigurisë publike, Zhvillimi ekonomik dhe mbështetja e iniciativave lokale. Objektivat, të cilat janë radhitur, i keni në material. Plani është hartuar duke u bazuar në buxhetin që është miratuar në shtatorë të vitit 2025 për vitin 2026.

Resul Suma thekson: Plani ishte i hartuar ashtu siç është më së miri. Te çështja e arsimit, mbështetja për studentë e di që është rritur, a keni planifikuar diçka më shumë për studentët në bazë të rritjes së numrit të studentëve?

Basri Dernjani thekson: E kam analizuar mirë këtë plan. Fillimisht dua të ju përgëzoj për punën e mirë që e keni bërë dhe kam parë disa projekte të cilat janë shumë në shërbim të qytetarëve, sidomos impakti është për tërë komunitetin e Hanit të Elezit, pa pasur ndonjë ndasi, por i përgjithshëm. Ajo që më ka lënë mbresa janë disa pika të cilat dua me ju referuar dhe të cilat janë shumë të rëndësishme dhe shumë të qëndrueshme, si tregu ditor, galeria-muzeu, si dhe ajo që është më e mira është futja nëntokësore e kablllove në Han të Elezit, ndërrimi i gypave të ujësjellësit. Ju përgëzoj për punën.

Medina Imishti thekson: Te drejtoria e administratës pashë vendosjen e ashensorit në objektin e komunës. Kërkoj sqarim se ku është planifikuar ky ashensor. Kërkoj nga drejtoresha e administratës që me futur në planin e punës presionin politik të stafit të cilin ajo e menaxhon, sepse faktikisht mendoj që detyra e vetme e kësaj drejtorie ka qenë gjatë mandatit të kaluar, mirëpo në bazë të informacioneve që kemi, ka filluar edhe në këtë mandat. Detyrë e vetme e kësaj drejtorie është presioni i stafit politik të cilin e menaxhon. Te drejtoria për kulturë pashë në planifikim dreka zyrtare 8,500 €. Për çka konkretisht bëhet fjalë? Te drejtoria e shëndetësisë, tek analiza e gjendjes aktuale janë theksuar nevojat për investime kapitale dhe pajisje mjekësore. Për çfarë pajisje mjekësore konkretisht ka nevojë QKMF-ja, sepse në njërin anë keni potencuar se QKMF ka

nevojë për pajisje, ndërsa në anën tjetër keni potencuar se është i planifikuar vetëm një gjenerator në vlerë prej 20,000 €. Te kontrolli i brendshëm, objektiven e marrjes së masave është shumë keq me shti në plan të punës, sepse marrja e masave është detyrë e secilit që punon në institucione e jo me qenë objektivë, sepse i bie që gjatë mandatit ke me u marr me këtë pjesë. Marrja e masave a do të bëhet për krejt stafin apo do t'i ndani sipas preferencave politike, siç keni bërë në mandatin e kaluar, ku farmacisten për shkak të shpërndarjes së luleve si kryetare e LVV-së e keni ndëshkuar? Tek përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, si objektiv i implementimit të mjekësisë familjare, kisha dashur me ditë se si do ta implementoni mjekësinë familjare, kur specialisten e vetme të mjekësisë familjare e mbani në kujdestari dhe nuk mendoj që kështu mundeni me implementuar mjekësinë familjare. Te rritja e stafit shëndetësor, për çfarë profile saktësisht ka nevojë QKMF-ja dhe a keni ndërmend që ta shtoni ndonjë shërbim të ri ose edhe ndonjë shërbim të ri në sektorin e laboratorit? Te drejtoria e urbanizmit, meqë projektet janë të përgjithshme, asfaltimi i rrugëve në fshatra, por a dihet konkretisht se cilat rrugë do të asfaltohen? E njëjta është edhe për muret mbrojtëse dhe për shtrimin e rrugëve me kupëza betoni. Pra, janë projekte të përgjithshme, por si drejtori a i keni të ndara specifikuat? Te drejtoria për shërbime publike pashë që drejtoria ka nevojë për staf, por për çfarë stafi ka nevojë aktualisht? A është duke e kryer dikush punën e inspektorit të ndërtimeve?

Mehmet Ballazhi thekson: E para është se ju kisha lutur shumë që pyetjet, diskutimet, rekomandimet t'i bëni pa emocione, pa paragjykime, se ky është një plan i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2026. Nëse keni diçka për me rekomanduar që me fut në plan, rekomandoni dhe sigurisht e vlerësoni dhe e rekomandoni. Pjesa politike janë politika që kanë dalë prej zgjedhjeve, por politikat e Kryetarit janë ato që ne i kemi paraparë me i zhvilluar. Se si do realizohen këto janë politika të ekzekutivit që na i kemi. Nëse paragjykon te marrja e masave dhe nëse ti paragjykon paraprakisht për selektim, atëherë ti je duke nxitur një selektim të tillë, një urrejtje ndërmjerëzore dhe nuk bën. Të kisha rekomanduar, se është mbledhja e parë, ju kisha ftuar që të jeni më të qetë dhe më bashkëpunues, më racional kur të kërkon diçka. Sa i përket ashensorit, mund të jetë mirëmbajtja e ashensorit. Sa i përket presionit politik, cilit staf politik? Te inspektori i ndërtimit, me sa janë në dijeni, kanë përfunduar procedurat ose ndoshta është faza përfundimtare, por më së paku një apo dy herë ka dështuar për arsye se nuk ka pasur adekuatë.

Nexhmedin Daci thekson: Sa i përket kodeve ekonomike për projektet, me siguri e dini që janë disa projekte standarde prej themelimit të komunës, siç është shtrim me kupëza betoni i rrugicave, mureve mbrojtëse, kanalizimeve, dhe është shumë më mirë me i mbajtur si të përgjithshme se sa me i paraqitur veç e veç. Ju e dini që buxheti miratohet në muajin shtator dhe para miratimit ligji na obligon me mbajtur dëgjime publike dhe jepen propozimet e kur të paraqiten në Kuvend. I kemi përmasat e sakta, ne mundemi me ditur shtrim me kupëza betoni të një rrugice. Për çdo vit shtatë apo tetë rrugica i shtrojmë, atëherë dalin komplikime tjera se duhet me i pasur shtatë apo tetë kode ekonomike me disa shuma të cilat nuk janë të sakta. Për shkak të uljes së kostos së shpenzimeve, shumë më mirë është në këtë formë me i mbajtur, sepse në vend që të shpallet një procedurë e prokurimit, na ishte dashur shtatë apo tetë procedura me i shpall. Në vend se të nënshkruhet një kontratë, duhet tetë kontrata të nënshkruhen, pra nevojiten tetë menaxherë të kontratave dhe është punë e lodhshme dhe jo efektive. Zakonisht Kuvendi e ndan një shumë të caktuar të këtyre mjeteve për këto projekte, pastaj ne synojmë sa më shumë rrugica me përfunduar.

Arbenita Bajramaliu thekson: Shuma e cila është planifikuar është për drekat për festivalin.

Hisni Luri thekson: Ne e kemi ndryshuar rregulloren për përfshirjen e bursave për studentë dhe do të fillojmë me atë rregullore që e kemi përcaktuar një numër, por me vendim të Kryetarit të Komunës, se nëse mbetet një numër i vogël jashtë listës dhe që i plotëson kriteret, do të përfshihen edhe ata.

Kimete Kuka-Hasallari thekson: Në këtë plan të punës është inkorporuar plani edhe i Qendrës së Mjekësisë Familjare në planin tim si drejtori. Te investimet është paraparë me pasur pajisje mjekësore, por jo çdo herë investimet i bëjmë me buxhet komunal, por fatmirësisht kemi bashkëpunim edhe me organizata të tjera që ato pajisje që i kemi planifikuar si drejtori duhet me i siguruar, por i siguron ndonjë organizatë që kemi përfutur edhe në vitet e kaluara. Gjeneratori është i nevojshëm sepse janë shtuar pajisjet dhe pjesa tjetër do të jetë në infrastrukturën e AMF-së dhe QKMF-së. Plan i punës për masat ndëshkuese është paraparë nga vetë

menaxhmenti i QKMF-së atje. Te masa ndëshkuese, siç e përmende farmacisten, je duke u kthyer shumë mbrapa me një ndëshkim që është bërë. Nuk besoj që është shumë e nevojshme të diskutohet ajo masë, për shkak se është stërdiskutuar në mandatin e kaluar, për shkak se nuk ka qenë dhurimi i luleve në aspektin e festës së gruas, por ka qenë në emër të forumit të gruas së Lëvizjes Vetëvendosje dhe se është mbajtur fjalim politik aty gjatë dhurimit të atyre luleve. Pikërisht arsyeja ka qenë e ndëshkimit të saj, nuk ka qenë asgjë politike. Në QKMF po zhvillohet politikë sa vetë në subjektet politike që janë prezentë. Te implementimi i mjekësisë familjare, ke qenë vetë udhëheqëse e kësaj drejtorie dhe e dini se çfarë sfida ka vazhdimisht dhe ju e dini që në tërë Kosovën mjek familjarë nuk po ka, për shkak se nuk po orientohen profesionistët e rinj që të marrin për specializim mjekësinë familjare. Normalisht që me këtë staf që e kemi jemi duke u mundur, se vetë koncepti i mjekësisë familjare jep llojin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për individin dhe për familjen në një komunë. Nëse nuk është mjeku familjar, shërbime kanë me ofruar edhe mjekët e përgjithshëm. Shkak që është në kujdestari mjekja familjare është se i ka një vit që është bërë, e kemi ushtruesin e detyrës së drejtorit që jep shërbime dhe e kemi edhe një nënë gjidhënëse që me ligj nuk preferohet që të jetë në ndërrime të natës dhe në kujdestari. Për shërbime specialistike do të mundohemi, në bashkëpunim me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, për me ofruar që të mundësohet për nevojat e qytetarëve, qoftë kardiolog, radiolog që janë të nevojshëm për Qendrën e Mjekësisë Familjare.

Medina Imishti thekson: I nderuar Kryetar, të falënderoj për sugjerimet, por unë i di shumë mirë punët dhe detyrat e mia në Kuvend. Unë potencova se nuk është mirë me qenë objektiv, sepse ke mundur në objektiva me pasur, sepse ata e potencon ligji dhe nuk ka nevojë me qenë objektiv i një drejtorie. Ndëshkimi i masave ndaj atyre që e shkelin ligjin, që e keqpërdorin buxhetin, e keqpërdorin detyrën që e përcakton ligji. Nëse e len në plan të punës si objektiv, i bie që ke me u marrë, se patjetër që ke me u marrë me masa ndëshkuese për ata që e shkelin ligjin. Sa i përket drejtorisë së administratës, nuk po reagoj me emocione, por është një mendim i imi dhe sa herë që i kam mendimet e mia do t'i them, dhe nëse të duken me emocione dhe politike, atëherë është mendim i joti. A keni planifikuar rritje të shërbimeve laboratorike?

Kimete Kuka-Hasallari thekson: Nëse është e nevojshme, me ato mundësi që i kemi do të shtohen, por për momentin jemi duke i kryer shërbimet dhe nuk janë të nevojshme të shtohen edhe tjera.

Mehmet Ballazhi thekson: Unë ju rekomandova dhe unë i di përgjegjësitë e mia që dalin prej ligjit. Me treguar se a është mirë apo nuk është, të uroj për këtë sugjerim, por i di detyrat e mia dhe ligjin dhe nuk e kam në objektiv diskriminimin politik të kërkoj. Nëse flasim për diskriminim, para 2021 ka pasur e jo pas 2021. Çfarëdo mase që do të merret, ka një instancë tjetër që na përmirëson edhe neve dhe vendimet tona. Kemi zbatuar çdo vendim që na është rekomanduar, por jo prej individëve të caktuar. Unë, si Kryetar Komune, të rekomandova ty që vjen emocionalisht në Kuvend, por do të jemi gjatë katër viteve dhe kështu është e dëmshme për shëndetin, sepse ju keni qenë Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe është mirë t'i merrni me relativitet.

Sead Vila thekson: Faqe 55, planifikimi urban dhe mjedisi, kam hasur disa mospërputhje të shifrave. Te pagat dhe mëditjet kam hasur disa mospërputhje të shifrave: 81,773.00 €, te mallrat dhe shërbimet 18,000 €, shpenzimet kapitale 440,480.00 €, e që në total për vitin 2026 i bie 540,253.00 €. Po t'i referohemi faqes 71, ku është përgatitur plani nga drejtori për urbanizëm, shifrat janë ndryshe: paga dhe mëditje 80,230 €, mallra dhe shërbime 20,000 €, shpenzimet kapitale 425,480 €, gjithsej buxheti 525,710 €. Pse është mospërputhja e këtyre shifrave? Te drejtoria e arsimit, faqe 57, potencohet se për vitin 2026 është planifikuar ndërtimi i institucionit arashkollor në Lagje të Re dhe ndërtimi i shkollës fillore në Lagje të Re. Pse nuk është ndarë buxhet? Më pëlqeu që është planifikuar takimi me këshillin e prindërve si aktivitet, si qëllim në kuadër të planit, por rekomandoj që të jetë pjesë praktike, jo vetëm me këshillin e prindërve, por edhe me këshillin e arsimtarëve. Pavarësisht hierarkisë që e keni në nivel me drejtorët, është mirë me i marrë opinionet, mendimet, të gjitha kërkesat e krejt institucioneve dhe partnerëve të cilët mund të vijnë në kuadër të drejtorisë së arsimit. Një pjesë që e pashë, me siguri është bërë gabim teknik, për shkak se paraqitet një analizë e suksesit për vitin 2021–2022, kur është punuar me tri periudha, me siguri ndoshta është bërë ndonjë gabim. Te drejtoria e arsimit është bërë një praktikë që mësimdhënësit po angazhohen nëpër komisione të konkurseve dhe po mendoj që kjo nuk kontribuon harmonisë kolegjiale dhe, me sa e kam vërejtur me kolegët, hezitojnë dhe nuk e marrin me shumë dashamirësi këtë aktivitet. Te drejtoria për shërbime publike është cekur se është zero, por tash në kohët e fundit, te konkurset, është pranuar një inspektor i ndërtimit, por kisha rekomanduar

që inspektori, nëse e ka për detyrë me dalë në terren, sidomos kur ndërtohen objektet ndërtimore banesore, me parë se si ndërtohen, sa janë masat mbrojtëse, sidomos në rrugën Adem Jashari, që unë vetë jam afër atij objekti banesor. Falë që i ka ruajtur Zoti, nuk është bërë diçka më e keqe, pra gjithçka punohet pa bërë ndonjë siguri të mirë për qytetarët në përgjithësi e në veçanti për nxënësit që frekuentojnë aty.

Menduh Vlasi thekson: Ju përshëndes në emër të grupit parlamentar të AAK-së për punën voluminoze që e keni bërë, sepse është punë e mundimshme me i bërë 95 faqe, por nëse hynë në brendësi të këtij plani, ka mundur me u bërë 25 deri në 30 faqe dhe me qenë shumë i kjashtë për të gjithë ne se çka doni me punuar në këtë vit e në fund, kur të ipet raporti i punës, me bërë krahasime. Një pjesë e madhe e drejtorive në planin e punës përshkruajnë punët dhe detyrat që dalin nga ligji për vetëqeverisje lokale apo nga statuti i komunës, apo nga ndonjë udhëzim administrativ. Te zyra ligjore, kryesisht shënohen punët dhe detyrat që dalin prej ligjit. Implementimi i rregulloreve të rekrutimit, disiplinës, orarit të punës, emërimit dhe rrugoret që do të dalin në bazë të ligjit, nuk kemi nevojë me shënuar këtë. Te zyra e prokurimit i ka përshkruar gati krejt drejtoritë e tjera që nuk janë të harmonizuara. Disa projekte shënohen te zyra e prokurimit, te drejtoritë jo. Disa shkruhet te drejtoritë e te prokurimi jo. Te kontrata kapitale, drejtoria e arsimit për infrastrukturë shkollore: shml "Dardani", shfm "Ilaz Thaçi", "Kështjella e Diturisë", "Veli Ballazhi", institucioni para-shkollore në vlerë prej 55,000 €, por është mirë me u shënuar saktë se çka keni me punuar. Ndërtimi i shkollës fillore në Lagje të Re dhe i çerdhës e dikun shënon vetëm shkolla fillore, por duhet të jetë e qartë se a do të ndërtohen të dyat apo njëra. Nëse mendoni në planin e juaj me i ndërtuar dyat, me sa e di unë nuk keni hapësirë aty për të dyat, por nuk është mirë me paraqitur në plan të punës kur nuk ke parcele për me i ndërtuar të dyat. Shtimi i kapaciteteve të ujit, unë nuk e kuptojë, kështu në të përgjithshme kemi me shtuar ujin, kemi me shtuar kupëza, por unë nuk kam ide se si do ta shtoni ujin në Lagje të Re, përmes shpimit apo përmes ndonjë burimi tjetër. Është shënuar realizimi i detyrave të punës në mënyrë të pavarur; unë nuk mundem me kuptuar posedimi i kapaciteteve funksionale për zhvillimin e politikave dhe strategjive. Drejtoria e administratës së përgjithshme potencon përgatitje dhe implementim të politikave komunale, por për cilat politika bëhet fjalë? Trajnim i përhershëm i personelit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale është dashur të planifikohet se kur do të mbahen dhe cilat. Takimet e rregullta me punëtorët e administratës komunale ndoshta i keni të përjavshme apo tërë vitin. Organizmi i dëgjimeve buxhetore te drejtoria për buxhet dhe financa, por është dashur me përcaktuar muajin se kurë. Njoftimi i realizimit të buxhetit sipas kategorive dhe nëse i ke njoftuar çdo muaj, e ju kanë tepruar aq shumë mjete, atëherë me drejtoritë nuk është në rregull. Lëshimi i faturave tatimore në afatin janar-mars; te lagjia ime nuk kanë ardhur së paku që tri vite, dhe nuk e di ku është faji. Te plani i ndarjeve buxhetore i paraqita dy vërejte, por nuk i kanë paraqitur. Do të ishte mirë që te tabelari në faqe 57 me dal edhe me përqindje poshtë. Unë i nxjerra me përqindje dhe sipas përqindjeve që më dalin mu për shpenzimet kapitale që komuna e Hanit të Elezit i ka 20.36%, e që realisht ky buxhet nuk është buxhet zhvillimor, se deri sa buxheti i komunës shkon kryesisht në paga dhe mëditje, subvencione, në shpenzime komunale, thjeshtë nuk ka zhvillim në komunë. Te drejtoria komunale e arsimit, për afërsisht, është plani para dhjetë viteve, vetëm i keni ndërruar data dhe i keni shtuar. Te sektori i urbanizmit, demolimi i lokaleve me përmbajtje azbestit në zonën qendrore të Hanit të Elezit, kjo ka qenë edhe më herët e me siguri vetëm e përcjellni, por është dashur të shënohet. Më poshtë shënon lista e projekteve kapitale të cilat janë miratuar në Kuvend Komunal, por po që se i mbledhim të gjitha shifrat, del një milionë e njëqind mijë e katërqind e tetëdhjetë euro për me i realizuar këto investime, ndërsa i keni katërqind e njëzet e pesë mijë euro ose edhe me bartje, që sipas llogarive del tetëqind mijë euro. Është mirë që të shënohen më pak projekte për aq sa keni mjete financiare dhe i kryni me kohë. Ndërtimi i sheshit të qytetit, kur do të kryhet? Thirrje për aplikim të fermerëve: Janar-Shtator. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport vetëm e ka ndarë për shkak se ka qenë bashkë me drejtorinë e arsimit, por është dashur një farë preambule me shënuar, por më pëlqen se është konkrete, por duhet edhe më konkrete të jetë dhe me ditë më datë nëntë dhe dhjetë prill, se çfarë aktivitete planifikon me bërë. Dy thënie të juaja më kanë pëlqyer: kur e keni marr mandatin e parë, e keni shënuar atje se Hani i Elezit nuk do të jetë vend kalim, por do të jetë vend qëndrim. Nuk po del kështu, Kryetarë. Sipas informatave që kemi, në Hani i Elezit po zbrazet, po largohen edhe qytetarët tanë, e në këtë faqe këtu e keni shënuar se "këtu kam lindur, këtu jam rritur", dhe zakonisht kjo fjalë përdoret në fund se "këtu do të vdesë". A mos keni në plan si ta kryni mandatin me hec për Ferizaj apo për Prishtinë? Hani i Elezit është në gjendje të rëndë; ju nuk jeni fajtorë, por jeni në krye dhe Hani i Elezit po zbrazet, e unë më herët kam pas potencuar se në Han të Elezit kanë me mbetur vetëm punëtorët e komunës, të shkollës dhe të ambulancës.

Kohët e fundit, pjesa e madhe e mësimdhënësve kanë blerë banesa dhe kanë shkuar me qira në Ferizaj. Kanë filluar me të madhe edhe zyrtarët; ndoshta edhe drejtorë të komunës po jetojnë në Ferizaj dhe të shëndetësisë. Është fatkeqësi shumë e madhe ku një mësimdhënës, kur e pyet se si po kolonë në Ferizaj, potencon se e kam shpëtuar familjen, dhe llogarit se çka pritë prej tjetrit kur ta dëgjon mësimdhënësin, mjekun apo zyrtarin e komunës me i shërbyer qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit, por ai jeton atje; po nuk më pengon, por nuk është mirë me potencuar që u kënaqem me kushte të mira atje, cilësi më e mirë e arsimit. Si Kryetarë, të kisha sugjeruar që mbliidhni një strukturë të njerëzve, kanë ta merr mendja ty dhe ulu me biseduar se çka duhet të bëjmë, na që mos të na ikin njerëzit; përndryshe e pamë atje, 20% i kemi investime kapitale, dhe nëse vazhdon ky trend, nuk ka me na mbetur as një përqindje për investime kapitale.

Kryesuesi thekson: Me gjithë respektin që kam, është mirë me ju përmbajtur afatit kohor, sepse e keni minutazhën.

Mehmet Ballazhi thekson: Ju faleminderit, z. Menduh Vlasi, që na mbajte një fjalim moralizues, por këtu jemi në Kuvend dhe nuk jemi as në oda apo në kafe siç e keni zakon me folur rrugëve dhe kafeve. E para, e ke shkelur rregulloren e Kuvendit për shkak se ke zgjatur përtej të mundshmes, se ty vetë ke qenë Kryesues i Kuvendit dhe vet keni potencuar disa herë që duhet t'i përmbahemi rregullave të Kuvendit, pra e keni shkelur pa mëshirshëm për me mbërri deri te ai qëllimi për me shprehur një mllef tëndin, që ty nuk mundesh me ja arritur, se nuk janë rrethanat e tilla çfarë ti mendon që janë. Po që jam lindur në Pustenic dhe jam rritur në Han të Elezit, po një pjesë të madhe të kohës jam rritur burgjeve dhe luftërave dhe kohës së sakrificës. Me vdekur nuk e di se ku e ka caktuar Allahu dhe ku që ta ketë caktuar, aty ka me vdekur, sepse kjo është çështje tjetër. Të kishim caktuar komisarë politikë, ndoshta në kohën e Socializmit të shteteve komuniste ishe kanë perfekt, dhe për ni mendësi zhvillimore të demokracisë e ke tejkaluar këtë dhe nuk je. E ke provuar mbi njëzet vite udhëheqje në çdo fushë, edhe në arsim, dhe aty ku po i banë kritikën tua, në pasojat që i kemi nga keq qeverisja që ti je kanë pjesë edhe e Kuvendit, edhe e drejtorisë, edhe ku do që ke punuar, pra janë pasojat që po mundohemi me i riparuar. A vend kalim apo vend qëndrim? Ne jemi në takime të përditshme të ndryshme, lëvizje të ndryshme dhe shohim sa është vend qëndrim këtu dhe shohim sa është bërë zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm. Ata që po e thua ty, nuk po ikin prej Hanit të Elezit, por prej Hanit të Elezit më së paku po ikin; po ikin prej Kosovës, e ato politika vetëm atë që e ki para vetës shpjegoja që ta përcjellin në qendër atje, sepse për nivel qëndrorë është kjo; është mendësi e largimit për shkak të politikave qëndrore diskriminuese që janë, a niveli lokal është shumë zhvillimor; është secili dëshmitarë tu nisur prej arsimit, prej ujit, infrastruktura dhe prej asaj pavarësisë politike që po mundohi ndoshta me devijuar. Mos e shfrytëzoni kuvendin me dal para mediave për diçka, se nuk jemi në oda. Për volumin e kësaj, ju i keni pasur nga 150 faqe, ndërsa na e kemi reduktuar në 95 faqe. U përmendë ndërtimi i shkollës, se a e keni në plan, por këto janë objektiva dhe janë të planifikuara dhe ne kishim pasur dëshirë që njëqind për qind me realizuar; s'mundemi me i realizuar, por objektiva tona janë. Nëse thue me shumë bindje që nuk ka një hapësirë atje për shkollë, a pe dinë sa sipërfaqe ka ajo hapësirë, por ne në objektivat tona e kemi, ne planifikojmë; nuk e di a e realizojmë apo nuk e realizojmë. Kështu, bëhu më konkretizues, më bashkëpunues, pak më relativ kur të diskutoni, sepse është Kuvend për me i plotësuar rekomandimet e juaja. Nëse ka ndonjë gabim drejtshkrimor apo mos përputhje të shifrave, ne i përmirësojmë e jo me mbajtur fjalime moralizuese, sepse nuk kemi nevojë.

Nexhmedin Daci thekson: Demolimi i objekteve që përmbajnë mbetje të azbestcimetos ka qenë në plan vitin e kaluar, mirëpo në Kosovë ka pak kompani që janë të licencuara për azbest; dy herë e kemi shpallur tenderin dhe ka dështuar, sepse aplikuesit nuk i kanë përmbushur kërkesat me ligj. Ne kemi me tentuar edhe në këtë vit me realizuar këtë projekt, por sa i përket kohës, nuk mundemi me ditë se kur rialokohet buxheti për shkak se financohet prej mallrave dhe shërbimeve. U përmend çështja e projekteve, ndoshta nuk ke mundur me i parë; projekti i parë është asfaltimi i rrugës së fshatit Gorancë, 694,000 €, e cila financohet prej Ministrisë së Infrastrukturës dhe mjetet financiare janë. Sa i përket buxhetit në Drejtorinë e Urbanizmit, buxheti i miratuar në Kuvend është dokument kredibil, edhe pse ai nuk është final, përderisa nuk miratohet nga Kuvendi i Kosovës, por çështja e shifrave mund të jetë gabim, por përmirësohet.

Hisni Luri thekson: Analiza është e shkollës, por ndoshta kemi harruar me shkruar vitin 2021; e deri sa të ekziston shkolla do të i bëhet. Rregullorja e përcakton se kush do të jetë në përzgjedhjen e konkurseve të cilat i shpallim si drejtori. Drejtorja e arsimit nuk ka lindur me ardhjen time si drejtor dhe nuk është plani siç e ke lënë në vitin 2016, sepse është veç arsimit e veç kultura, që kanë qenë shumë bashkëpunime, por tash e kam specifikuar vetë. Sa i përket planifikimit të ndërtimeve, pse jemi zero-zero aktualisht, na duhet shpronësimi me u bërë që parcela me i takuar komunës; pastaj e ndërtojmë edhe çerdhen edhe shkollën, por ne nuk e ndërtojmë, sepse edhe nëse e kishim përcaktuar një shumë, e kishim 1,000 €, por ideja ka qenë që ne e kemi pasur vitin e kaluar kështu, dhe pastaj është dashur që ato mjete me i bartur diku tjetër, sepse nuk kemi mundur me i realizuar, sepse ne e dimë që planifikimet nuk mund të realizohen brenda një viti. Ndërtimi i çerdes dhe i shkollës nuk realizohet për një vit, por ne duhet ta kemi si kod, se këto i ndërton Ministria e Arsimit. Çështjen të cilën e potencove që po dali me jetuar në Ferizaj, dhe askush prej atyre që jetojnë në Ferizaj nuk janë të kënaqur me sistemin e arsimit atje. Të gjithë ata të cilët i kanë dërguar fëmijët janë të pakënaqur me sistemin e arsimit atje, sepse është më mirë këtu. Sa i përket infrastrukturës shkollore që e kemi, ne e dimë se çka kemi me punuar dhe me një procedurë mundemi me i kryer të gjitha këto dhe nuk mundemi si procedura veç e veç, se na marrin kohë. Çështjen e këshillit të prindërve e kemi shtijë në plan dhe po mundohemi diçka me bërë, por tash është e nevojshme edhe me këshillin e nxënësve dhe mësimeve; e kemi pasur, por nuk ka qenë e shpërfaqur kjo. Nga dita e parë kur kemi kërkuar e kemi kërkuar një çështje të tillë që me pasur bashkëpunim me prindërit.

Lindita Ballazhi thekson: për çështjen e faturave të tatimit në pronë ju njoftoj që ne kemi marrëveshje me Postën e Kosovës dhe shpërndarja e faturave të tatimit në pronë bëhet nga Posta e Kosovës, pra departamenti i tatimit në pronë drejtë për së drejti komunikimin e ka me Postën e Kosovës, që ato i dërgojnë faturat e tatimit në pronë te Posta e Kosovës dhe ato e bëjnë shpërndarjen e tyre. Ne kemi një marrëveshje me letër rekomandë; pronari i faturës së tatimit në pronë e jep nënshkrimin e vetë që e ka pranuar faturën. Pasi që nuk e keni pranuar faturën e tatimit në pronë, është dashur të paraqiteni në drejtorinë apo te zyrtari i tatimit në pronë dhe, normalisht, që do të ishit pajisur me atë faturë të tatimit në pronë. Vazhdimisht kemi bërë njoftime në vebfaqen komunale. Gjatë vitit 2025 ka ndodhur një gabim teknik nga departamenti i tatimit në pronë që nuk janë shtypur të gjitha faturat e tatimit në pronë, por departamenti i tatimit në pronë ka dalë edhe me njoftim zyrtarë, të cilin edhe ne e kemi bërë njoftimin në vebfaqe të komunës.

Majlinda Kaloshi thekson: te intervali kohor për dy aktivitete të planifikuara shënon janar-dhjetorë, për shkak se shpesh herë këto organizime planifikohen nga Ministritë, Agjencitë dhe organizatat e ndryshme; kështu që ne nuk e kemi një datë të caktuar, andaj preferohet të shënohet e gjithë periudha e vitit. Sa i përket sheshit të qytetit, nuk është e vërtetë që nuk është intervali kohor, por është periudha qershor-dhjetor, e ndarë sipas fazave, shkak se është projekt që e financojnë Ministritë e Linjës.

Menduh Vlasi thekson: unë e kuptoj se çka është objektiva dhe çka është plani i vitit 2026. Në objektivi ti mund të shëndosh çka të duash, se e ke edhe mandatin tjetër, por unë po flas për vitin 2026. Më vjen mirë që kemi synime shumë, por kur ta paraqitni raportin e punës nuk mundeni me i realizuar as 50%. E paraqet planin e punës se shpresoni në Ministri apo ndonjë donacion tjetër, ju kuptoj, por vazhdimisht është mirë me shpërndarë në ato dy projekte që i ke, se nëse e shpërndanë në shumë vende pastaj s'u i bartë dhe pastaj ju teprojnë mjetet financiare. Sa i përket që e zgjata për atë me kanë pru qytetarët këtu mi shqyrtuar. Nëse Kryetar mendon që duhet shkurt me diskutuar një plan, mundesh mos me na e sjellë dhe ne nuk e diskutojmë hiq. Deri sa të vjen plani 95 faqe dhe për dy apo tre minuta me kryer, nuk ndodh, sepse dua ta them atë që dua, dhe ndoshta e kam gabim, por ju vazhdoni punën e juaj.

Visar Hasallari thekson: fillimisht, uroj që ky plan i punës i planifikuar nga ekzekutivi i komunës të realizohet sa më mirë në dobi të qytetarëve. Gjatë dëgjimeve buxhetore, si qytetarë i lagjes së re, kam kërkuar disa herë që ka të bëjë për sigurinë e vendit, ka qenë pastrimi i përroit dhe, sa për sqarim, në të kaluarën ka pasur një pastrim nga komuna dhe vlera e projektit afërsisht ka qenë afër 10,000 €. Nëse ky projekt nuk është futur në investime kapitale, kërkoj një mundësi që të futet ky projekt në investime kapitale.

Nexhmedin Daci thekson: kjo nuk është investim kapital; ajo do të kryhet, se pagesa bëhet prej mallrave dhe shërbimeve. Drejtorja e Shërbimeve Publike e ka të planifikuar.

Basri Dernjani thekson: z. Menduh Vlasi tha se po bëni planifikime në investime kapitale vetëm 20%. Unë e di që janë krejt grafikonet dhe janë shumë të qarta, dhe secila drejtori e ka të planifikuar buxhetin të përcaktuar, dhe për çdo investim është një vlerë monetare. Mjetet janë të planifikuara afër katër milion euro dhe secili kod investiv e ka vlerën; a zbatohet apo implementohet, neve na mbetet me parë në fund. Ne e dimë grantin që na vjen prej Qeverisë, që në tërë Kosovën 90% e buxhetit shkon për paga dhe mëditi; investime kapitale, por ne mundemi me planifikuar pak më shumë nëse marrim ndonjë donacion apo grant prej Qeverisë.

Sherif Bushi thekson: te drejtoria për shërbime publike kam hasur riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatra si Paldenicë, mirëpo Lagjen e Ujit të Thartë nuk e di a keni futur si zonë kadastrale me Paldenicë apo me Han të Elezit. Për katër vite qeverisje nuk ka asnjë investim në atë lagje, dhe investimet të cilat kanë qenë nga qeverisja e kaluar kanë filluar me u dëmtuar. Trotuari që e lidh rrugën me Hanin e Elezit është i dëmtuar në shumicën e pjesëve, anësoret mbi 50% janë të dëmtuara, ndriçimi nga një herë nuk është funksional. Rruga Lidhja e Prizrenit në atë lagje, ku shumica e kupëzve janë të dëmtuara, dhe ndriçimi po thuaj se është komplet i dëmtuar. Nga banorët kam ankesa që shumica e pjesëve të rrugëve në atë pjesë janë të dëmtuara. Në atë lagje është problem edhe rryma elektrike, ku shumica e shtyllave janë të dëmtuara, edhe pse nuk është kompetencë e juaj; me një trysni ndaj KEDS-it mundet me marrë parasysh, sepse si lagje kemi bërë kërkesë në KEDS, por nuk na e kanë marrë parasysh. Ku do të ndërtohet tregu në Han të Elezit dhe sa ka me ju ndihmuar ky treg prodhuesve vendorë?

Mehmet Ballazhi thekson: nuk e di që nuk është bërë asnjë investim në atë pjesë, dhe të fundit, me sa e di, është një rrugicë me kupëza betoni që ka filluar, por nuk ka përfunduar; po ashtu, jemi marrë me çështje të ujit dhe tash planifikojmë ndërrimin e gypave kryesorë. Aty ku ka pasur kërkesa ka investime, sa do që të vogla ka pasur investime. Te shtyllat elektrike janë përgjegjësi e KEDS-it, se këtë problem e kemi të gjithë, jo vetëm ju. Me një projekt që kemi bërë, trysni më në fund e kanë realizuar gjysmën e projektit në fshatin Krivenik për ndërrimin e shtyllave, dhe ka mbetur i pa përfunduar për shkak të neglizhencës dhe pa përgjegjësisë së KEDS-it. Ndriçimi është defekt i përgjithshëm, që na duhet me plotësuar për shkak të shtimit të kapacitetit të ndriçimit secilën pjesë të ndriçimit me trafo të veçanta, për shkak se ka shumë ngarkesë dhe shumë probleme. Lagja Uji Thartë është me Han të Elezit, por duhet me shikuar me zonë kadastrale si është e definuar.

Majlinda Kaloshi thekson: tregu planifikohet të ndërtohet prapa komunës, dhe parcela është afër komunës, por do të kryhen fazat e shpronësimit. Për ekonominë lokale si projekt ndikon shumë, sepse kemi pasur ankesa edhe prej bujqve që nuk kanë hapësira të mjaftueshme për me i promovuar produktet e tyre. Kiosket janë sistem montazhe dhe lëvizëse, dhe kjo hapësirë ka me mundur me u shfrytëzuar edhe për panairë tradicionale.

Sherif Bushi thekson: te drejtoria për shëndetësi dhe për punë sociale, mungesa e stafit në disa profile; çka keni bërë si drejtori për mungesën e stafit dhe moslargimin e mjekëve nga Hani i Elezit? Si do të bëhet shtimi i stafit në drejtime deficitare, por si do ta bëni këtë kur po e shohim që mjekët nga Hani i Elezit jo vetëm shkojnë jashtë shteti, por edhe në shtetet tjera?

Hatmije Kalisi thekson: në objektivat e juaj pashë stimulimin e nxënësve në shkollat profesionale. Nëpër fshatra, nxënësit që udhëtojnë prej shkollës së mesme të ulët, me ua kryer shpenzimet e udhëtimit.

Ferdi Topojani thekson: te drejtoria e shërbimeve publike kam disa pyetje. Siç e dini, Hani i Elezit përballët me mungesë të ujit të pijshëm; si drejtor, çfarë investimesh keni paraparë për këtë çështje, se keni ndarë 15,000 €? Ju keni dhe zyrtarin për hapësira publike; a keni paraparë mbikëqyrje dhe gjobitje ndaj personave që i dëmtojnë pronat publike, veçanërisht parkun "Isa Berisha", që është i dëmtuar dhe vazhdon me u dëmtuar?

Mehmet Ballazhi thekson: për çështjen e udhëtimit të nxënësve kemi të bëjmë me buxhetin e vitit të kaluar, dhe në bazë të buxhetit veprojmë, por nuk do të thotë që nuk i subvencionojmë; e kemi diskutuar disa herë, por do të shikohet në aspektin ligjor, dhe e kemi parasysh, sepse ka qenë kërkesë nga fshati Gorancë. E kemi diskutuar edhe çështjen e udhëtimit edhe për në Ferizaj, por problemi më i madh është i çështjes së vijave të autobusëve, se sa vetë stimulimi për ta. Për çështjen e shtimit të kapaciteteve të ujit dhe rrjetit të ujësjellësit, është një plan projekt që është prej kompanisë “Bifurkacioni” dhe në bashkëpunim me kompaninë “Sharrcem”, dhe natyrisht edhe me mbështetje të komunës, do të bëhet ndërrimi i gypave kryesorë, që të shihet humbja, për shkak se humbje janë dy të tretat nga prodhimi i ujit. Sa i përket dëmtimit të hapësirave publike, nuk është vetëm te ky park, por edhe te hapësirat tjera; për to përshihen gjobat me rregullore.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2026

3. Raporti financiar për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti i komunës së Hanit të Elezit, i ndarë sipas Ligjit me NR. 08/L-332 “Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025”, është në lartësi prej 3,615,457.00 euro. Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike, si në vijim: Paga dhe shtesa – 2,188,542.00 €, Mallra dhe shërbime – 584,500.00 €, Shpenzimet komunale – 94,000.00 €, Subvencione dhe transfere – 143,000.00 €, Shpenzime kapitale – 605,415.00 €. Totali i buxhetit – 3,615,457.00 €.

Ndërsa buxheti përfundimtar është 4,984,585.91 €, ku në këtë shumë përfshihen:

1. Shuma e ndarë nga grantet qeveritare në shumë prej 3,420,701.44 €;
2. Të hyrat vetanake komunale në shumë prej 1,146,193.72 €;
3. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024 në vitin 2025 në shumë prej 170,771.67 €;
4. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dyvjeçar “A Smart System for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 234,029.45 €;
5. Pjesë e mbetur e donacionit nga Qeveria Japoneze për projektin “Ndërtimi i aneksit për këmbësor në urën e Secishtës” në shumë prej 8,775.95 €;
6. Donacione të mbetura nga vitet paraprake në shumë prej 113.68 €;
7. Donacioni nga Këshilli i Evropës në shumë prej 4,000.00 €.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm, del se niveli i shpenzimit të buxhetit për vitin fiskal 2025 është në shumë prej 4,362,901.78 €. Projektioni i të hyrave vetanake komunale për vitin 2025 është në shumë prej 339,719.00 €. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtojë gjithsej nga të hyrat direkte dhe indirekte për vitin fiskal 2025 në shumë prej 1,234,220.74 €, apo 263.3 % tejkallim të planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024 kemi një rritje të inkasimit për 917,200.08 €.

Pagesat nga kategoria buxhetore “Paga dhe shtesa” janë shpenzuar në shumë prej 2,333,505.44 €, ose 100.00 % të planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin fiskal 2024 pagesat për këtë kategori kanë një rritje për 192,364.02 €. Pagesat për këtë kategori buxhetore “Mallra dhe shërbime” për vitin fiskal 2025 janë në shumë prej 885,908.70 €, apo 84.51 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin fiskal 2024 kemi një rritje prej 366,114.52 €. Pagesat për shpenzime komunale për vitin fiskal 2025 janë në shumë prej 111,622.88 €, apo 97.91 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin fiskal 2024 kemi një rritje prej 30,403.21 €. Pagesat nga kategoria “Subvencione dhe transfere” për vitin fiskal 2025 janë në shumë prej 193,519.48 €, apo 100.00 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me vitin fiskal 2024 kemi një rënie të shpenzimit prej 177,439.00 €. Pagesat nga kategoria buxhetore “Investime kapitale” për vitin fiskal 2025 janë në shumë prej 838,345.28 €, ndërsa krahasuar me vitin fiskal 2024 shpenzimi për këtë kategori është më i lartë për 367,782.09 €.

Gjithsej shpenzimet për vitin fiskal 2025, për të gjitha kategoritë buxhetore, janë në shumë prej 4,362,901.78 €, apo 87.53 % e planit të përgjithshëm vjetor, ndërsa në krahasim me vitin fiskal 2024 kemi një rritje për 21.74 %, apo 779,224.84 €.

Sead Vila thekson: pse ky raport Janar-Dhjetor është shënuar “jo për publikim”? Shihet se diku afër 87.3 % është shpenzuar buxheti dhe 12.47 %, pra 621,684.13 €, janë të pa shpenzuara. Kërkoj sqarim se pse nuk janë shpenzuar këto mjete.

Menduh Vlashi thekson: sa i përket raportit, e përgëzoj drejtoreshën; është paraqitur mirë, edhe pse ekonomistët dinë me kalkular në realizim të projektit dhe në dështim të projektit. Zakonisht në raport paraqesin që kemi tejkaluar, kemi tejkaluar, por nuk e paraqet qartë se ku kemi ngecur. Si raport nuk kam ndonjë vërejtje të veçantë, por te faqja numër dy potencohet se, nisur nga vlerësimi i përgjithshëm, del se buxheti për vitin 2025 është në shumë prej 4,362,901.78 €. Po të llogaritet sa ka qenë buxheti dhe sa është shpenzuar, del se suficit kanë mbetur 621,684.13 €, e që për mua, definitivisht, është e pakjartë se si vjen deri te kjo gjendje që mos me mundur me shpenzuar buxhetin. Për mua është e papranueshme kjo dhe nuk e di arsyen; ju duhet ta kërkonit te drejtorët, sepse nëse raportohen për shpenzimet e buxhetit për çdo muaj, atëherë drejtorët nuk kanë qenë në nivel që mos me ju tepruar mjetet financiare. Edhe në Komitet për Politikë e Financa potencova që është mirë me u shtuar edhe një rubrikë që të dalë në përqindje. Këtë që në fillim e potencoj: z. Sead Vila, “jo për publikim”, nuk e di ku qëndron arsyeja; buxheti është publik, edhe i Kosovës edhe i Komunës, dhe duhet të publikohet edhe në webfaqe. Webfaqja është mirë me u përpunuar, se nuk dalin materialet me kohë dhe të tërësishëm në webfaqe.

Mehmet Ballazhi thekson: e pra, që potencuat “jo për publikim”, por kjo është draft. Zakonisht draftin nuk mundesh me publikuar pa e diskutuar, dhe pas diskutimit kjo do të publikohet. Nuk është shqetësuese vetëm për ty nëse tepronë diçka, por është për gjithë neve. Por për neve është më shumë shqetësuese se pse nuk po realizohet, për shkak se ne e dimë pak a shumë edhe rrethanat dhe zhvillimin e politikave që bëhet këtu, qoftë individuale, nga një herë të zyrave të ndryshme të personave të caktuar. Unë po e paraqes një shembull: kur ka filluar projekti “Ura e Seçishtës” me Qeverinë Japoneze, që kanë qenë të planifikuar 45,000 €, dhe kur zhvillohen procedurat e tenderimit, ofertuesi sipas ligjit është ai që ka çmim më të lirë, dhe kompania ka ofertuar me 32,000 €, që i bien 15,000 € më lirë. Kështu, 15 % të mjeteve të projektit nuk mundesh me i shfrytëzuar, por ne jemi mundur që me i shfrytëzuar me një aneks të projektit. Po shoh se te grandit performancës e keni problemin, por nëse ne e kemi planifikuar shpronësimin në vlerë prej 80,000 € dhe planifikojnë edhe në këtë vit, dhe a realizohet apo nuk realizohet, ne e kemi 20 % të shpronësimeve me i paguar; Qeveria na i qet barrë, ose AKP-ja 600,000 € me i paguar, që ne nuk i kemi mundësitë. Ato pasojat që potencova më herët, prej fabrikës së ujit, prej fushës së futbollit, prej shtëpisë së kulturës, prej parcelës mbrapa ku parashihet të bëhet tregu i gjelbërt, ne vazhdimisht e kemi përcjell shpronësimin e tyre, që si procedurë nuk ka kaluar, dhe si vjet kanë kërkuar 600,000 €, ne e kemi stopuar dhe kërkojmë prej Qeverisë që ata të kryejnë këtë pjesë. Kjo tani e rrit numrin e suficitit ose të tepicës së mjeteve që nuk kemi mundur me i realizuar, dhe 80,000 € nuk kanë qenë të dedikuara diku tjetër, por janë për shpronësim.

Menduh Vlashi thekson: unë ju kuptoj, por sipas meje, ky është mendimi im, sepse suficiti mbetet për shkak të planifikimit jo të mirë të buxhetit. Po të bëhet planifikimi i mirë, sipas meje, këto projekte që i keni ju duhet të i keni paramasat dhe parlogaritë; dhe nëse nuk i keni për vitin tjetër, punoni në këtë vit, sepse e dini për afërsisht se çfarë projekte keni me pasur për vitin 2027. I bëni paramasat dhe parlogaritë dhe i ndani mjetet financiare; dhe nga muaji mars i filloni tenderët, dhe pjesa që tepron në muajin qershor i rishikoni. Po që se nuk bëhet planifikim i mirë i buxhetit, unë e di që mbetet, por jo kjo shumë, mundet me mbetur 5 apo 7 %. Kemi komuna që kanë pasur 5 %, por për Hanin e Elezit këto mjete janë shumë.

Nexhmedin Daci thekson: u potencua që planifikimi ka qenë i dobët, por unë besoj që pajtohemi se buxheti i vitit 2025, si plan buxhetor, po që se shikohet, në çdo aspekt e kemi tejkaluar. Nëse thirrsh në plan, 37.5 % është rritja e buxhetit, 226 % është rritja e të hyrave vetanake, e cila nuk ka ndodhur asnjëherë. Gjithë kategoritë buxhetore: paga dhe mëditje 6.6 % ka qenë mbi plan; mallra dhe shërbime 81.5 %; komunalitë 18.7 %; subvencione dhe transfere 34.9 %; dhe kapitale 38.4 %. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për dështim. Kur flasim për buxhetin final, së pari, kur bëhet një analizë financiare, duhesh me këqyrë planin; pra, ne e kemi tejkaluar atë 37.5 %. Buxheti final ka pasur rritje prej një milion eurosh, dhe është e pamundur, për shkak se ato mjete nuk i kemi pasur në fillim të vitit, por janë ardhur pas muajit qershor. Ju e dini që kur të rriten të hyrat vetanake mbi plan, nuk ki drejtë me i shpenzuar pa marrë vendim Kuvendi për rritje të buxhetit; kjo procedurë

i merr një muaj e më shumë, po ashtu një muaj e më shumë i merr Ministria e Financave për shkak se edhe ajo duhet të japë pëlqim për shpenzim të këtij buxheti. Do të thotë, ne i kemi pasur dy muaj për me shpenzuar këtë tejkallim të buxhetit, që ka qenë e pamundur, sepse ju i dini procedurat e tenderimit. Për shpronësimin e fabrikës së ujit dhe stadiumit i kemi pasur 85,000 €, por AKP-ja na i ka përcjell faturën 625,000 €; ne nuk e kemi parë të arsyeshme me i paguar këto mjete dhe me rritë përqindjen e shpenzimeve kapitale, por nuk është vendim i mirë. I kemi IPA fondet, që ministria me vonesë pjesën e vetë e ka paguar, por na e keni kontraktuar blerjen e një kamionete; rregullat e Bashkimit Evropian lejojnë vetëm 40 % avanc, por ne kemi mundur me rrezikuar me ja paguar kompanisë 100 %, por kishim bërë shkelje të rregullave financiare. Kemi projekte kapitale të cilat nuk kanë përfunduar, dhe ajo që është me rëndësi, asnjë projekt kapital nuk është i kërcënuar dhe do të vazhdojnë punimet.

Menduh Vlasi thekson: unë nuk e kam kuptuar çështjen e tejkallimit të të hyrave vetanake. Mos u thirrni që e kemi ngritur buxhetin me paratë që nuk i keni shpenzuar; njëjtë po vepron edhe Qeveria lartë.

Mehmet Ballazhi thekson: rritja është bërë dyfish, se nuk e kemi vetëm me shifra, por janë mjetet. Është shpronësimi që ka ndodhur nga punimet e autostradës, që është rritje enorme. Për me shpenzuar paratë publike në momentet kur të alokohen në buxhet në llogari të komunës në muajin nëntor, a ke ti ndonjë ide se si ta shfrytëzosh këtë buxhet, p.sh. mjetet e Bashkimit Evropian që hyjnë në kategorinë e investimeve kapitale; një vit ka pasur në muajin nëntor dhe një vit janë alokuar në muajin dhjetor, e asnjë mundësi ligjore nuk e ke me shpenzuar atë buxhet brenda një muaji apo një muaji e gjysmë. Nuk ka asnjë mundësi; ne e kemi shikuar, dhe për atë del si suficit për shkak se është rritur buxheti në muajin nëntor, e nuk e kemi pasur të planifikuar. Ne kemi kërkuar që mos me futur shumën e investimeve kapitale në buxhet, por sipas miratimit në shtator, por Qeveria apo kushdo që është përgjegjës në departamentin e financave është dashur me menduar që mos me na e lënë neve barrë këtë mos-shpenzim, që është i pamundshëm, sepse e shpjegojë edhe drejtori i Urbanizmit, që duhen dy apo tre muaj që me u zhvilluar procedurat e gjitha për me u realizuar, pra minimumi, nëse nuk ka probleme të tjera të lëndëve që kanë shkuar në OSHP, që ju kanë dhënë mundësi tash e jo sikur para 2021 janë koordinuar mirë, janë bërë pagesat pa u kryer punët, dhe ne nuk kemi dashur me shkel ligjin.

Lindita Ballazhi thekson: sa i përket asaj që është shënuar “jo për publikim”, Kryetari e sqaroi shumë mirë, dhe kjo është për këto arsye: pasi që në fund të muajit dhjetor kemi pranuar një shumë të mjeteve nga Bashkimi Evropian dhe ende nuk është alokuar në kategoritë përkatëse buxhetore. Ne punën tonë si komunë e kemi kryer, por duhet ti marrim rekomandimet nga Bashkimi Evropian se në çfarë kategorie buxhetore duhet të alokohen këto mjete të këtij donacioni përkatës, dhe nga momenti që do dihet, do të vazhdojmë me alokimin e këtij donacioni, dhe aty ku do të alokohet do të ndryshojnë shumat e asaj kategorie. Të hyrat individuale që përfshijnë gjokat në trafik, gjykatat, si dhe gjokat nga Agjensia Pyjore e Kosovës për TM4 ende nuk i kemi pranuar, kështu që edhe këtu do të ketë një ndryshim tek të hyrat vetanake, si dhe datën në të cilën është dërguar ky raport; ne ende nuk kemi qenë të barazuar në thesar, dhe pa u barazuar me thesar nuk mund të llogarisim një raport final. Ky raport nuk mundet ende të publikohet, pasi që do të ketë ndryshime. Në faqe 18 të raportit është një tabelë që është shumë e qartë për çdo burim të financimit, sa ka qenë i alokuar, sa i shpenzuar dhe sa kanë mbetur obligime në pritje. Është shumë i qartë në faqen 18 që mund ta shihni çdo burim të financimit, sa ka qenë i alokuar, sa është shpenzimi dhe sa është mbetja. U përmend që raporti duhet të publikohet, pasi që buxheti është publikuar, por buxheti ende nuk është publikuar në Kuvend të Kosovës; edhe kur të publikohet për vitin 2026, raporti që e keni për diskutim ka të bëjë me vitin 2025 dhe ju mund ta publikoni, por unë ju njoftoj që do të ketë ndryshime, kur të pranohen të hyrat vetanake nga divizioni i të hyrave vetanake të donacionit nga Bashkimi Evropian. Në faqen katër e keni tabelën me të hyrat vetanake, me drejtori, si dhe me kode ekonomike, dhe aty mund të shihni se si janë realizuar të hyrat vetanake.

Basri Dernjani thekson: në përgjithësi, në analizën time që e kam bërë, asnjë komunë, as në Qeveri, nuk e kam parë këtë projeksion tejkallim të planifikimit buxhetor prej 37 %, që nuk e di a ka ndodhur ndonjëherë në histori. Kjo është fatmirësi e jona në këtë rast, që e tregoi edhe Kryetari i Komunës dhe Drejtoresha, por duhet me qenë shumë të kënaqur se të gjitha kategoritë buxhetore kanë pasur rritje, dhe ju përgëzoj për punën.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës; nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2026.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson: me të gjithë faktorët relevantë të këtij këshilli e kemi diskutuar se cilat janë pikat që mund ti paraqesim në plan, apo mos të i përsërisim, por nuk ka pasur diçka shumë të veçantë; por kemi marrë rekomandime edhe gjatë Kuvendit të Komunës, kur është diskutuar ndonjë pikë. Ne i kemi përfshirë të gjithë ato që ndikojnë në sigurinë. Janë të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen; është koha e zhvillimit të aktiviteteve. Materialin e keni pranuar, dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2026

5. Propozim vendim në parim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: ky propozim vendim ka të bëjë për dhënien në shfrytëzim të pronave të Komunës për vitin 2026. Janë gjithsej katër parcela; dy janë në Pustenik, dy janë në fshatin Rezhancë. Të dhënat për këto parcele i keni në propozim vendim. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i këtyre parcelave është nxitja e aktiviteteve në fushën e bujqësisë. Parcelet do të epen në shfrytëzim për periudhën afatgjatë 15 deri në 99 vite, me një çmim fillestar prej 100 € për hektar. Po ashtu, dhënia në shfrytëzim do të bëhet sipas procedurave ligjore përmes ankandit publik, dhe të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë qytetarët e komunës.

Medina Imishti thekson: si opozitë e konsiderojmë të rëndësishëm zhvillimin ekonomik në sektorin e bujqësisë dhe ekonomisë. Për këtë propozim-vendim unë i kam disa pyetje. Së pari, këtë propozim-vendim e keni sjellë pa ndonjë analizë ekonomike të qartë, sepse ky vendim nuk na garanton neve që fermerët lokal dhe blegtorët kanë me qenë përfitues, dhe duke e marrë këtë vendim mundemi me rrezikuar që prona publike të bien në dorë të subjekteve të ndryshme ekonomike. Sa i përket çështjes së afatit, drejtori përmendi 15 deri 99; nuk jam i sigurt, por kërkoj sqarim, se në pikën që ju jeni thirrur është 99. Nëse është vetëm 99, mendoj që është një afat tejet i gjatë për me i dhënë këto prona dhe me i rrezikuar që mos me pasur zhvillim. A keni kërkesa aktualisht, apo pas ankandit keni me parë se çfarë kërkesa keni? Çka parashihet ligji në rast të mos investimeve dhe mos shfrytëzimit të saj, a ka mekanizma që e parashohin rishikimin apo ndërprerjen e kontratës nëse ipet?

Menduh Vlasi thekson: sa i përket kësaj pike, edhe në Komitet për Politikë e Financa në parim isha pro, mirëpo pata një kërkesë në Komitet për Politikë e Financa që paraprakisht me u formuar një ekip e komunës dhe me biseduar me banorët e atij fshati ku është kjo parcelë, e pastaj me hy me procedurë. Por drejtori potencoi se është pronë komunale dhe shpallet tenderi, dhe me këto parime unë do të jem kundër, për shkak se nuk është mirë që çdo pronë publike e përbashkët me u privatizuar. Në fshatin Rezhancë atë pronë e kanë të përbashkët, që mundën me luajtur futboll fëmijët apo me i lëshuar bagëtinë. A do të mbetet rruga? Parcelat në Pustenik janë parcela që i kanë shfrytëzuar me shekuj njerëzit, dhe në kohën e komunizmit qytetarët për shkak shtesave fminore i kanë hequr prej sistemit dhe nuk janë në emër të tyre; përndryshe, sipas informatave që kam, ato dy parcele i shfrytëzojnë personat. I them edhe opozitës se para se me marrë vendimin është mirë me menduar mirë, sepse edhe në mbledhje të KPF-së kam potencuar se çka është kjo nguti që në mbledhjen e parë të Kuvendit të Komunës me dhënë në shfrytëzim pronë. Vjen propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim dhe pas kësaj i kemi formimin e komisioneve, dhe kjo është nguti e madhe që më shtinë me dyshuar.

Mehmet Ballazhi thekson: kërkesa nuk ka parashtruar askush dhe nuk e di a ka të interesuar, por që katër vite e kemi paraqitur pronat e lira të komunës që janë për shfrytëzim, dhe askush nuk ka paraqitur asnjë herë kërkesë. Pra, ligji dhe rregullorja e përcakton dhënien në shfrytëzim të pronave të cilat janë të komunës. Me paragjykuar se çka mundet me ndodhë nuk e dimë, por po veprojmë në aspektin ligjor.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte 9 për, 6 kundër.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI NË PARIM PËR DHËNINË NË SHFRYTËZIM AFATËGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME.

6. Propozim-vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Basri Dernjani thekson: për anëtarë të komisionit, në emër të Partisë Demokratike propozoj z. Shefket Lusnjani.

Medina Imishti thekson: nga Lëvizja Vetëvendosje nuk kemi propozim.

Menduh Vlasi thekson: nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk kemi propozim.

Visar Hasallari thekson: për anëtarë të komisionit, në emër të Lidhjes Demokratike propozoj znj. Ibadete Kuka.

Mehmet Ballazhi thekson: në emër të ekzekutivit të komunës propozoj z. Nexhmedin Daci dhe z. Abduram Bushi.

Visar Hasallari thekson: propozoj znj. Mevlane Kalsisi si OJQ.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte 9 për, 6 kundër.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR DHËNINË NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS.

7. Propozim-vendim për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Basri Dernjani thekson: për anëtarë të komisionit, në emër të Partisë Demokratike propozoj znj. Nora Xhoni.

Medina Imishti thekson: nga Lëvizja Vetëvendosje nuk kemi propozim.

Menduh Vlasi thekson: nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk kemi propozim.

Visar Hasallari thekson: për anëtarë të komisionit, në emër të Lidhjes Demokratike propozoj znj. Hanumshahe Dibrani.

Mehmet Ballazhi thekson: në emër të ekzekutivit të komunës propozoj znj. Arbenita Bajramaliu dhe znj. Majlinda Kaloshi.

Resul Suma thekson: propozoj z. Endrit Ballazhi si OJQ.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte 9 për, 6 kundër.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE NË PROCEDURAT E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS.

8. Propozim vendim për përbërjen e komisionit komunal të aksionarëve të NPL Pastrimi.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson: Ligji për ndërmarrjet publike potencon se një anëtar i komisionit duhet të propozohet nga Kryetari i Komunës, por në propozim-vendim shënon që një anëtarë nga ekzekutivi i komunës, ndërsa në vendimin e më hershëm pjesë ka qenë një shërbyese civile. Ekzekutiv a e nënkupton të emëruar politikë apo komplet stafin e administratës.

Mehmet Ballazhi thekson: në momentin që thuhet "nga ekzekutivi", Kryetari i Komunës propozon.

Basri Dernjani thekson: për anëtarë të komisionit në emër të Partisë Demokratike, propozoj z. Resul Suma.

Medina Imishti thekson: nga Lëvizja Vetëvendosje, propozoj z. Ferdi Topojani.

Menduh Vlasi thekson: nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, propozoj z. Sherif Bushi.

Visar Hasallari thekson: për anëtarë të komisionit në emër të Lidhjes Demokratike, propozojë znj. Hanumshahe Dibrani.

Mehmet Ballazhi thekson: për anëtarë të komisionit komunal të aksionarëve të NPL Pastrimi, propozoj znj. Sevime Bajrami.

Kryesuesi thekson: propozimin e z. Basri Dernjani e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për, 3 kundër. Propozimin e znj. Medina Imishti e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 6 për, 9 kundër. Propozimin e z. Menduh Vlasi e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 6 për, 9 kundër. Propozimin e z. Visar Hasallari e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 9 për, 6 kundër. Në tërësi, e hedh në votim komisionin komunal të aksionarëve të NPL Pastrimi; rezultati i votimit ishte 13 për, 1 kundër dhe 1 abstenim.

U MIRATUA PROPOZIM-VENDIMI PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NPL PASTRIMI.

9. Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Basri Dernjani thekson: mbledhje kemi mbajtur me datë 20.01.2026 dhe kemi propozuar një draft-plan për vitin 2026. Jemi mundura që në këtë plan të përfshihen të gjithë drejtorët. Po ashtu, ne do të paraqesim në Kuvend edhe kërkesat të cilat vijnë nga qytetarët.

Sead Vila thekson: më herët kishte qenë praktikë jo e mirë që drejtorët dhe zyrtarët mos t'i përgjigjeshin këtyre takimeve, por pasi që një herë në vit po ftohet një drejtor i drejtorisë përkatëse, do të ishte mirë me marrë pjesë në atë takim dhe me i diskutuar qoftë pyetjet dhe sugjerimet për kërkesat që vijnë nga qytetarët.

Menduh Vlashi thekson: është mirë që t'i përcjellë pikat e Komitetit për Politikë e Financa dhe kur ka pika që kanë të bëjnë me komunitetin, edhe mbledhje urgjente me thirr nuk do të ishte keq.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2026.

10. Informatë mbi veprimtarinë e subjekteve afariste për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson: Drejtorja, në kuadër të saj, ka edhe Qendrën për Regjistrim të Bizneseve, e cila kryen të gjitha shërbimet sa i përket bizneseve lokale. Në Han të Elezit, nga bizneset e regjistruara dhe sipas të dhënave në ARBK, kemi paraqitur një grafikë e cila paraqet një analizë sipas sektorëve ekonomik në përqindje. Këto kategori përfshijnë: Tregtinë (20%), Aktivitete shërbyese (16%), Transporti (18%), Ndërtimtaria (6%), Të tjera (40%). Po ashtu kemi edhe sektorin për taksat e ushtrimit të veprimtarisë, që në vitin 2025 janë inkasuar 75,485.00 €. Për kategorizimin e aktivitetit apo bizneseve që kanë shuar aktivitetin, janë të gjitha biznese individuale dhe nuk është mirë të hyjmë me emra për shkak të privatësisë.

Sead Vila thekson: – pjesa 40% "të tjera" më duket shifër shumë e lartë; është mirë me u detajuar se në çfarë sektorë më detajisht, kur ka pasur hapësirë ndërtimtaria me 6%. Çfarë përqindje janë kategoritë e tjera dhe çfarë sektori, sepse është shumë e lartë, gati gjysma e totalit.

Medina Imishti thekson: sipas informacionit që e keni paraqitur në material, keni paraqitur vetëm 20 inspektime, që më duket numër i vogël duke e krahasuar me numrin e bizneseve që aktualisht janë në komunë. Kërkoj sqarim se pse janë kaq inspektime, cilat biznese janë inspektuar dhe pse në informacionin e inspektimeve është përfshirë periudha janar-dhjetor.

Menduh Vlashi thekson: do të ishte mirë që me ndonjë mbledhje tjetër të dërgohet një raport dyvjeçar apo trevjeçar se sa biznese janë shtuar të reja dhe sa biznese janë shuar.

Majlinda Kaloshi thekson: është e vërtetë që 40% i kategorive është numër i lartë, dhe në bazë të kodeve të regjistrimit të bizneseve dhe statistikave që i nxjerrim prej drejtorisë, normalisht regjistrohen direkt në ARBK. Numri i kodeve për secilin biznes është relativisht shumë i madh; mundet me qenë vetëm një biznes i regjistruar që nuk i përket kategorive të tjera dhe llogaritet me një përqindje shumë të vogël. Sa i përket inspektimeve për periudhën janar-qershor, është gabim drejtshkrimor; periudha është janar-dhjetor dhe inspektimet janë kryer normalisht aq sa ka pasur nevojë. Te ato inspektime ka pasur procesverbale dhe raporte të cilat inspektori i tregut i mban. Gjatë periudhës 2025 nuk kemi pasur gjoba, por më herët ka pasur edhe shkelje ku inspektori është detyruar t'i gjobisë bizneset.

Visar Hasallari thekson: pyetja ime ka qenë kështu: kategoria e bizneseve që kanë qenë në shuarje, kam dashur me ditë fushë veprimtarinë e tyre, cila ka qenë.

Resul Suma thekson: inkasimi për vitin 2025 shihet që e vetmja që është inkasuar është taksa e veprimtarisë së kompanisë "Sharrcem". Dallimi prej 95,000 € në 75,000 € faturimi dhe inkasimi. Sa është niveli i borxhit të bizneseve ndaj komunës?

Majlinda Kaloshi thekson: nuk është vetëm kompania "Sharrcem", sepse tatimohet me 60,000 €, ndërsa pjesa tjetër është prej bizneseve të tjera. Faturimi bëhet sipas rregullores që është për taksa dhe tarifa, ndërsa sa i përket inkasimit kemi shumë telashe që na kanë ndjekur vit pas viti. Për me zbutur llojin e diferencës kemi marr masa, kemi tentuar për me komunikuar dhe kemi krijuar marrëveshje me bizneset në mënyrë që me ndarë borxhin në këste që me mundur me rënë, por vlera e borxheve është shumë e madhe që e kalon numrin mbi 305,000 €.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës; nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson: unë do të parashtroj tri pyetje, për të cilat kërkoj të më jepen përgjigje me shkrim:

1. Çështja e ndriçimit publik te kufiri, prej zonës te taksistët deri te zona e kufirit, prej se është punuar në projektin e zgjerimit të rrugës, nuk ka ndriçim. Kur do të rregullohet ndriçimi?
2. Për mbledhjen e radhës të sjellët raporti i fundit i kompanisë Bifurkacioni për cilësinë e ujit të Dimcës dhe për cilësinë e ujit të Gllloboçicës.
3. Ka ankesa të zyrtarëve komunal që nuk u jepet pushimi vjetor, që unë besoj se kanë të drejtë ligjore për me shfrytëzuar pushimin vjetor, ashtu siç shënon Ligji.

Mehmet Ballazhi thekson: sa i përket ndriçimit publik, keni mundur me parashtuar një kërkesë me shkrim në drejtorinë përkatëse. Aty ku po e potenconi, ka pasur herë pas here ndërprerje, por ka pasur ndriçim. Sa i përket pushimit vjetor, është mirë që të potenconi se kujt nuk i është dhënë pushimi vjetor, dhe është puna e zyrtarëve me ardhur dhe me kërkuar pushimin vjetor, e jo me kërkuar prej anëtarëve të kuvendit, sepse ju nuk mundeni me ditë se kur e ka kërkuar dhe a e ka kërkuar me sistem, për shkak se po dilet në rrafshin e rrugëve për çështje që janë të institucionit. Ai që ka problem në institucion, zgjidhjen e problemit e kërkon brenda institucionit.

Menduh Vlasi thekson: pjesa e lagjes afër një javë nuk ka ndriçim, ndërsa pjesa ku janë kryer punimet ndoshta ndonjë herë ka pasur, por në shumicën e rasteve nuk ka pasur. Sa i përket çështjes së pushimit, bëhet fjalë për z. Xhevdet Bushi dhe z. Ali Rexha.

Mehmet Ballazhi thekson: nuk besoj që je përfaqësues as i Ali Rexha, as i Xhevdet Bushi, sepse ata përfaqësohen përmes ligjit në komunë dhe nuk mundesh me zgjidh; e nëse është vetëm për me bërë mediale politike, është diçka tjetër. Ndërsa nëse mendoni për me zgjidhur, nuk mundeni për shkak se janë rregullat dhe procedurat.

Medina Imishti thekson: është duke u punuar te hekurudha; a ka leje? A është projekt i komunës, apo është duke i kryer punimet hekurudha? A munden këto punime të jenë pengesë për përdorimin e stadiumit “Suad Brava”?

Mehmet Ballazhi thekson: leje kanë dhe punimet kanë filluar edhe më herët; janë duke i shtruar kablllo të rrymës. Stadiumi mund të shfrytëzohet.

Sead Vila thekson: ajo që më ka rënë në sy kohët e fundit është se kompania “Bifurkacioni” ka vetëm dy zyrtarë në teren, të cilët punojnë për sajimin e dëmtimeve që bëhen në rrjetin e ujësjellësit. A ka mundësi me u shtuar ky numër? Te rojet e pyjeve, normalisht gjithmonë ka qenë shqetësim prerja ilegale e pyjeve, qoftë private, qoftë shtetërore. Kam informacion se numri është shumë i vogël, edhe pse ky departament është te Ministria. Mirëpo, a mundet komuna me bërë kërkesë që të shtohet numri i zyrtarëve të pyjeve? Për çështjen e kontratës kolektive, na është potencuar se gjatë vitit 2025 do të realizohen të gjitha pagesat për punëtorët e arsimit për përmbushjen e kontratës kolektive. Ka neglizhime apo ngecje, dhe dikush potencon se te gjykata, dikush potencon mësimdhënësit, dikush potencon komuna. A mundemi me ditë ku është kjo pengesë, pasi një pjesë e konsiderueshme e mësimdhënësve akoma në vitin 2026 nuk i kanë marrë obligimet të cilat ju takojnë me kontratën kolektive?

Mehmet Ballazhi thekson: çështja e shtimit të punëtorëve në kompaninë “Bifurkacioni” nuk është kompetencë e jona, por ne ju kemi kërkuar në fakt në aspektin njerëzor, për shkak se nuk kemi drejtë ligjore. Çështja e rojeve të pyjeve ka qenë në kuadër të komunës, por është bartur te Agjensioni i Pyjeve dhe nuk kemi të drejtë me shtuar numër apo me inkuadruar persona brenda kësaj. Te kontrata kolektive, ne kemi bërë përpjekje maksimale, para gjitha komunave, me vullnetin tonë, në bashkëpunim me sindikatën dhe avokatët e punëtorëve të arsimit, që vullneti ka qenë me i kryer sa më shpejtë, por është pjesa procedurale që secili avokat e din se si i ka ndarë procedurat për secilin mësimtar. Pjesa dërmuese është kryer, por është çështje procedurale e gjykatës se si i thirr dhe kur e parasheh të arsyeshme. Por, ne kemi bërë përpjekje që të kryhet sa më shpejtë.

Visar Hasallri thekson: më lejoni që të ngrej një shqetësim i cili prek drejtpërdrejt interesin publik dhe mirëqenien e qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit. Që nga viti 2026, kompania e cila menaxhon furnizimin me ujë të pijshëm, “Bifurkacioni”, ka marrë një vendim të ndjeshëm për rritjen e tarifave: më konkretisht, për amvisëri nga 0.39 € sa ishte në vitin 2025 në 0.53 € në vitin 2026, për biznese nga 0.54 € në vitin 2025 në 0.69 € në vitin 2026. Kjo përfaqëson një rritje të konsiderueshme të koston për qytetarët dhe bizneset lokale, por problemi bëhet edhe më i rëndë, sepse në të njëjtën periudhë kjo kompani ka ulur kapacitetin e prodhimit të ujit, nga 18 litra në sekond sa ishte, në 13 litra, duke shkaktuar mungesë serioze të ujit të pijshëm, për të cilën qytetarët po ankohen çdo ditë. Kemi një situatë paradoksale dhe të papranueshme, sepse në të njëjtën kohë kemi rritjen e çmimit dhe, ndërkohë, ulet sasia e furnizimit me ujë. Kjo bie ndesh me çdo parim të shërbimeve publike dhe përgjegjësin që institucionet dhe operatori e ka ndaj qytetarëve. Me çfarë arsytimi është miratuar kjo ngritje e çmimit? A është njoftuar apo konsultuar komuna për këtë vendim? Pse është ulur prodhimi i ujit dhe a ka ndonjë plan konkret për shtimin e kapaciteteve për 18 litra për sekond? Çfarë masash po merren për të garantuar furnizim të qëndrueshëm me ujë, sidomos për periudhën e verës? Si asamblastë dhe përfaqësues të qytetarëve, kërkoj nga ekzekutivi i komunës që të sqarojë urgjentisht këtë situatë. Kërkoj llogaridhënie nga kompania “Bifurkacioni” dhe të merren hapa konkretë për pezullimin e rritjes së këtij çmimi ose rishikimin e saj, deri sa të garantohet furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm. Ne e dimë që uji i pijshëm është nevojë bazike dhe qytetarët e komunës nuk duhet të paguajnë më shumë, por më pak. Kërkoj që kjo situatë të trajtohet urgjentisht dhe të kërkohet llogari nga kompania “Bifurkacioni”, dhe të ndalohet rritja e çmimit deri sa qytetarët të kenë ujë të rregullt dhe të mjaftueshëm.

Mehmet Ballazhi thekson: ne jemi takuar, por jo kohët e fundit, por edhe çështjen e ujit e kemi diskutuar disa herë, edhe kur keni qenë në organizatën e KVRL-së. E kemi diskutuar problemin, mënyrën e zgjidhjes, mundësitë e zgjidhjes dhe besoj kemi arritur në një nivel të kënaqshëm për zgjidhjen e problemit të ujit. Nuk është përfundimtar, sepse e kam potencuar në media dhe gjithkund, por ne kemi arritur të stabilizojmë çështjen e ujit të pijes apo të përdorimit të përditshëm. Pse është rritur çmimi, nuk e di, por ne nuk menaxhojmë, nuk ia imponojmë dhe nuk kemi rregullore për rritjen e çmimit të ujit, sepse nuk na takon neve. Nuk mundemi me ndikuar, nuk mundemi me qit me një rrafsh personal, por edhe nëse e qesim vetëm me shkëputur bashkëpunim që e kemi me ta. Obligimi jonë ka qenë me krijuar një vijë bashkëpunimi të sinqertë për interesa të komunitetit. Herën e fundit nuk kam qenë prezentë një javë, dhe e di që ka pasur zvogëlim të ujit në 15 litra në sekond. Edhe në fillim potencova kur u parashtrua një pyetje: dikund dy të treta e ujit humbin, dhe ende nuk dihet se ku humbin, që do të thotë nëntë litra në sekond humbin, që do të thotë gjashtë litra përdoren. Për këtë arsye kemi ardhur në përfundim që duhet të ndërrohen gypat kryesorë, për të cilën më herët potencova se do të ndërrohet pjesa e ujit të thartë: pjesa prej Shell-it deri te kufiri, prej shkollës së mesme deri te ndërtesa në fund, dhe pjesa prej qendrës deri te hekurudha. Sipas ekspertëve të inxhinierëve të cilët i kanë atje dhe sipas këtij planifikimi, ata parashohin se kjo është zgjidhja e këtij problemi të ujit. Të drejtë nuk kemi me ua imponuar zvogëlimin e uljes së çmimit apo rritjes, sepse janë politika të tyre që ata e konsiderojnë të arsyeshme. Unë personalisht kisha dashur me bërë rritjen e pagesës së mbeturinave, sepse është shumë që nuk po munden t'i mbulojnë për shkak se janë rritur faturat, ku këta e bëjnë zbrazjen; pra është rritur diku tre apo katërfish, por neve na vjen keq me propozuar në kuvend që të kërkojmë për me i rrit çmimin për pagesën e mbeturinave. Si komunë nuk mundemi me bërë diçka për uljen e faturave të ujit, për shkak se janë politika të tyre nën kujdesjen e Qeverisë, sepse i kanë kompetencat atje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta

